



22.03.2020

Letër për prindër nr. 3

Rregullorja e re për përkujdesjen e fëmijëve nga personat, që janë duke punuar në infrastrukturë kritike (personat kyç)

APEL I RËNDËSISHËM
në të gjithë prindërit,
të cilët për shkak të rregullores së re
kanë të drejt për përkujdesje të fëmijëve

Për të siguruar mbarëvajtjen e infrastrukturës kritike për të mirën e përgjithshme Qeveria e Landit ka vendosur, që çdo person, që vepron në infrastrukturë kritike, dhe mund ta jap një vërtetim të punëdhënësit që është i pazëvendësueshëm, pavarësisht nga gjendja familjare ka të drejtë për përkujdesjen e fëmijëve të tij në një institucion të kopshteve të fëmijëve, nëse përkujdesja e fëmijëve nuk mund të organizohet me përgjegjësi të plotë dikund tjetër – në përputhje me rekomandimet e RKI-së.

Kjo rregullore vlen nga 23.03.2020 dhe vlen si për përkujdesjen në institucionet e kopshteve të fëmijëve poashtu edhe në institucionet e fëmijëve, që kanë nevojë ditore mjekësore.

Ne apelojmë poashtu tek prindërit:

Nga arsyet e mbrojtjes nga infekcionet **do të duhej që të shfrytëzohet kjo rregullore në masën e minimumit të saj.** Ju lutem, që t'i sillni fëmijët në kopsht vetëm nëse keni **me të vertetë** nevojë për përkujdesje dhe nuk mund ta bëni organizimin vetë ose me vetëpërgjegjësi - sipas rekomandimeve të RKI-së.

Ndihmoni në ngadalësimin e përhapjes së koronavirusit, në mënyë që numrin e përkujdesjeve në kopsht mos ta rrisni më shumë se që është e nevojshme. Ta keni parasysh, që me çdo kontakt plotësues jashtë familjes **rritet rreziku i infektimit** për fëmion tuaj dhe familjen tuaj. Ju lutem mendoni edhe në shëndetin dhe mirëqenien e kujdestareve dhe kujdestarëve në kopshtet e fëmijëve.

E gjithë popullata është e thirrur, që të mënjanoj kontaktet sociale sa është e mundur.
Ju lutem merrni pjesë edhe ju në këtë.

Ministria për Fëmijë, Familje, Refugjat dhe Integrim i Landit Nordrhein-Westfalen